

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"HOXHA 2023"

KAPITULLI
EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1- Forma

1. Shoqëria tregtare **“HOXHA 2023”** (më poshtë shënuar “shoqëria”), sot me date 23 Gusht 2023 **krijohet në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar**. Veprimtaria e saj rregullohet nga ky Statut, Akti i Themelimit dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.
2. Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe çdo çështje e paparashikuar shprehimisht në të, rregullohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 2-Emërtimi

1. Shoqëria emërtohet **“HOXHA 2023” SH.P.K.** Emërtimi i shoqërisë mund të shkruhet me shkronja të mëdha ose të vogla.
2. Të gjitha shkresat, formularët e urdhërave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo nga zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës apo mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:
 - a. numrin unik të identifikimit;
 - b. formën ligjore të shoqërisë, SH.P.K;
 - c. vëndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
 - d. të dhëna nëse shoqëria është në likuidim.

Neni 3-Selia

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në, Lagjja”4 Shtatori”,Ruga ” Aleks Ormenaj” ,Numri i pasurise 2/124-ND,Zona kadastrale 3682 ,Ura Vajgurore” . Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri dhe jashtë saj, qendra, përfaqësi, filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

Neni 4- Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 5- Objekti i veprimtarisë.

Objekti i shoqërisë është si më poshtë:

- Import-eksport, prodhim dhe tregetim te mobiljeve dhe lendes se pare per to.Ekspozim te produkteve te prodhuara prej saj.
- Shoqëria mundet të realizoje çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brënda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 6- Përgjegjësia

Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qellime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti dhe Akti i Themelimit. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortakët në emrin e tyre personal ndaj personave fizikë, juridikë, privat ose publik, brënda ose jashtë shtetit.

K A P I T U L L I I I

KAPITALI I RREGJISTRUAR, KONTRIBUTET, NDARJA E KUOTAVE TË KAPITALIT

Neni 7- Kapitali i Rregjistruar.

1. **Kapitali i rregjistruar i shoqërisë është 2,000.000 (Dymilion) lekë.**
2. **Kapitali i rregjistruar është i përbërë nga 2 kuota kapitali me vlerë nominale 1.000.000(Njemilion) lekë secila, të gjitha të nënshkruara dhe të paguara.**

Neni 8-Kontributet dhe kuotat e kapitalit të rregjistruar.

Sipas kontributeve në kapitalin e rregjistruar të shoqërisë,

- z. Dionis Zhuka i biri i Laverit me datelindje 03.12.1971 dhe nr NID H11203002B është Ortak dhe zotëron 1 kuote kapitali dhe 50 % të kapitalit të rregjistruar të shoqërisë.
- Znj.Kludia Myzeqari e bija e Faikut me datelindje 15.07.1991 dhe me nr NID J15715001J është Ortak dhe zotëron 1 kuote kapitali dhe 50 % të kapitalit të rregjistruar të shoqërisë

Neni 9- Zmadhimi i Kapitalit të Rregjistruar.

1. Kapitali i rregjistruar mund të rritet pa kufij në çfardo momenti, një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
2. Në rast rritjeje të kapitalit të rregjistruar, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me kuotat e kapitalit të zotëruar.
3. Në rast se ata nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesëmarrjen respektive dhe në rast mungese te nënshkrimit, mund të nënshkruen nga të tretët me miratim të ortakëve.

Neni 10- Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar.

1. Me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e rregjistruar. Në të gjitha rastet kapitali i rregjistruar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
2. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe miratimin të ortakut/ëve përkatës,

shoqëria ka të drejtën e anulimit dhe likuidimit të kuotave të kapitalit. Me anulimin e tyre, të drejtat e detyrimit që i rrjedhin ortakut nga zotërimi i kuotës, shuhen.

Neni 11- Kuotat dhe kalimi i kuotave të kapitalit.

1. Zotërimi i kuotave, mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave, pjestimi dhe transferimi i tyre do të bëhen sipas procedurave të parashikuara në ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe nga përcaktimet e këtij neni në vijim.
2. Kuotat e kapitalit mund tu transferohen të tereve ose ortakëve tërësisht ose pjesërisht, vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar.
3. Ortaku që kërkon të transferojë kuotat e tij duhet të njoftojë për projektin e tij si administratorin ashtu edhe sejcilin ortak. Njoftimi duhet të bëhet me letër rekomande me kthim përgjigje për marrjen e njoftimit. Mbledhja e Asamblesë për miratimin ose refuzimin e projektit të transferimit duhet të bëhet brenda 2 muajve nga data e njoftimit.
4. Vendimi i ortakëve i njoftohet transferuesit me letër rekomande më kërkesë për marrje lajmërimi për marrjen e vendimit. Në rast se shoqëria nuk ka vendosur brenda tre muajve, nga data e njoftimit të fundit, miratimi konsiderohet i dhënë.
5. Në rast se shoqëria refuzon të japë miratimin e transferimit, brenda tre muajëve nga data e këtij refuzimi, ortakët duhet të blejnë ose të lejojnë blerjen e kuotave të kapitalit me vleresimin e të drejtave me ekspert vlerësues të caktuar nga palët ose kur ata nuk merren vesh ndërmjet tyre, me ekspert të caktuar nga Gjykata.
6. Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe sipas modaliteteve të përcaktuara nga Administratorët. Kjo kontrate do të dërgohet në selinë e shoqërisë.
7. Administratorët mund të refuzojnë rregjistrimin e kalimit të kuotës në QKR në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht.
8. Ortakët mund të vendosin që blerja e kuotave të kryet nga vetë shoqëria duke zvogëluar kapitalin themeltar të shoqërisë.
9. Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgimi ose brenda familjes bëhet me miratim të ortakëve me kushte jo më pak të favorshme se ato të caktuara për të tretët.

KAPITULLI III **ASAMBLEJA, ADMINISTRIMI, KONTROLI**

Neni 12- Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

1. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b. ndryshimet e statutit;
 - c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;

- d. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmëndur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
 - f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “g” dhe “h” të paragrafit të mësipërm, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentave përkatës.
3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm rregjistrohen në një rregjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen apo të fshihen. Duhet rregjistruar në vecanti, po pa u kufizuar vetëm në to, vendimet për:
- a. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b. shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c. investime;
 - d. vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- Vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm dhe të pa rregjistruara në rregjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme

Neni 13- Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- a. Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji Nr.9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nga ligje të tjera, nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. *Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.*
- b. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori/ët apo ortakët e pakicës siç është e përcaktuar në nenin 84 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- c. Asambleja e Përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- d. Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
- e. Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
- f. Në rastet e parashikuara në pikat “c” e “e” të këtij neni, Asamblesë së Përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
- g. Dispozitat e pikës “f” të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave “d” e “e” të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte

normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një Ortak i Vetëm.

- h. Në rastet e parashikuara në pikat “c” deri në “e” të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

Neni 14- Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 Ditë të Plota përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
2. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas paragrafit të parë të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
3. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni.
Nëse, Asambleja e Përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë të ndjekë rrugët ligjore të përcaktuara në nenin 84 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 15- Përfaqësimi në Asamble, kuorumi, marrja e vendimeve.

1. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
2. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme ndahen në vendime që kërkojnë një shumicë të zakonshme dhe në vendime të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar. Vendimet që kërkojnë shumicë të kualifikuar janë vendimet: *për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.*
3. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të këtij statuti.
4. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

5. Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështjet që kërkojnë shumicë të kualifikuar si; *për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.*
6. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e tjera të zakonshme, me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
7. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, vendimet që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, kushtëzohen nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 16-E drejta e pjesëmarrjes dhe e votimit.

1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e vet dhe të marrë pjesë nëpërmjet votës së tij në vendime. Ai disponon një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit që zotëron. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
2. Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një delegat i pajisur me një prokurë të shkruar, me anë të së cilës mund të japë votën e tij. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.
3. Një ortakë, nuk mund të delegojë të drejtën për të votuar, në emër të një pjese të kapitalit të tij themeltar, duke votuar personalisht për pjesën tjetër të kapitalit themeltar.
4. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mund të sigurojnë mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve dhe të plotësohen kerkesat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- 4 Ortakët kanë të drejtën, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.
- 5 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Neni 17-Procesverbalet e Mbledhjes së Asamblesë.

Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbalit duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbalit i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Neni 18-Hetimet e posaçme.

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare ne perputhje me kerkesat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” për hetimet e posaçme.

Neni 19- Administratori/ët, emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet

1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator persona fizikë, qofshin këta dhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori/ët qendrojnë në postin e tyre për pesë vjet financiarë, me mundësinë për tu rizgjedhur.
2. Administratori/ët kanë të drejtë e detyrohen të zbatojnë të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë e caktuara nga ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe statuti.
3. Administratori/ët kanë të gjitha të drejtat për të vepruar në mardhënie me të tretët, në interes të shoqërisë dhe në emër të saj, në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo statuti ja jep Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
4. **Administratori i parë i shoqërisë është z. Dionis Zhuka, banues në lagjen 28 Nentori ,Ura Vajgurore. Afati i vlefshmerise se tij do te jete nga data 23/08/2023 deri me date 22/08/2028 me te drejte rizgjedhje.**Ai do të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për rregjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit(QKR). Të gjitha shpenzimet që do të kryen deri në rregjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin e shoqërisë.

Neni 20- Ekspertët Kontabël të Autorizuar.

Shoqëria do të kontrollohet nga një ose disa ekspertë kontabël të autorizuar të zgjedhur nga lista e Institutit të Eksperteve Kontabël të Rregjistruar, të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme, sipas kërkesave dhe rregullave të legjislationit për auditimin e pavarur.

KAPITULLI IV **VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

Neni 21- Viti financiar dhe pasqyrat financiare.

1. Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor.
Viti i pare financiar fillon në datën e rregjistrimit të Shoqërisë në Rregjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Tiranë dhe përfundon në 31 dhjetor të të njëjtit vit.
2. Pasqyrat financiare, raporti i administrimit dhe i ekspertit/ve kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe statut.

Neni 22- Marrdhëniet ndërmjet shoqërisë dhe ortakëve.

1. Pas miratimit të pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë, ortakët kanë të drejtë të percaktojnë destinacionin e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare. Fitimi i deklaruar, mund të destinohet për rritjen e kapitalit të regjistruar, shpërndarje në formë dividendesh, fitim të pacaktuar apo ndonjë rezervë tjetër që vendos Asambleja. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.
2. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit, aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj dhe shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim, bazuar në një certifikatë të aftësisë së paguese të lëshuar nga administratori.

KAPITULLI V
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË NË GJËNDJEN E AFTËSISË PAGUESE

Neni 23- Prishja, Likuidimi.

1. Përfunduar rastet e një prishje të parashikuar nga ligji, shoqëria mund të priset në çdo kohë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
2. Përveç rastit të bashkimit ose të ndarjes, prishja e shoqërisë për çfardo shkak qoftë sjell likuidimin e saj. Likuidimi kryet nga një ose disa likuidatorë të emëruar nga Asambleja, të cilet kryejnë këtë detyrë në përputhje me statutin e shoqërisë, ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe kërkesat e tjera ligjore.
3. Likuidatori përfaqëson shoqërinë. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil, shpërblimin e likuiduesit/ve së bashku me rimbursimin e shpenzimeve dhe aktivet e mbetura u shpërndahen ortakëve në përpjestim me kuotat në kapitalin e regjistruar.
4. Me përfundimin e procedurës së likuidimit të shoqërisë, Asambleja do të vendosë, mbi bilancin financiar përfundimtar mbi vlefshmerine e punës së kryer nga likuiduesit dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
5. Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet një procedurë të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët e saj dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.
6. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me ligjin “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 24- Riorganizimi i shoqërisë.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore, në përputhje me kërkesat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe dispozitave të tjera ligjore.

Neni 25-Kundërshtimet.

Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj, midis ortakëve ose një apo më shumë prej tyre dhe shoqërisë, do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur miqësisht. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

Neni 26- Shpenzimet.

Të gjitha shpenzimet e kryera përpara firmosjes së statutit dhe ato midis datës së firmosjes së statutit e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, janë shpenzime që do të përballohen nga shoqëria.

Neni 27- Të tjera

Ky statut është përgatitur në katër kopje.

Ure Vajgurore me 23/08/2023

THEMELUESI I SHOQËRISË “HOXHA2023” SH.P.K

Dionis Zhuka



Klaudia Myzeqari

